

VENDIM
Nr.1576, datë 17.10.2008

**PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE TË FUNKSIONIMIT TË DREJTORISË SË
PËRGJITHSHME TË METROLOGJISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 7 të ligjit nr.9875, datë 14.2.2008 “Për metrologjinë”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, me qendër në Tiranë, organizohet me qendra rajonale në Tiranë, Korçë, Fier dhe Lezhë.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë drejtohet nga drejtori i përgjithshëm, i cili emërohet nga Kryeministri, me propozimin e ministrit përgjegjës për ekonominë. Rekrutimi i nëpunësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë bëhet sipas kushteve dhe kritereve, të përcaktuara në ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”. Për punonjësit mbështetës zbatohet Kodi i Punës.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ka për detyrë:

- ta zhvillojë dhe menaxhojë sistemin kombëtar të metrologjisë në Shqipëri, në përputhje me kërkesat ndërkombëtare dhe me nevojat kombëtare;

- t'i mbrojë interesat e konsumatorëve dhe të shtetit, nëpërmjet organizimit të kontrollit të mjeteve matëse, që përdoren për matje në transaksionet tregtare dhe zyrtare, kujdesin shëndetësor, mjedisin, rendin publik, sigurinë dhe mbrojtjen e konsumatorëve;

- t'u ofrojë mundësi prodhuesve dhe përdoruesve për të garantuar saktësinë e mjeteve matëse, për të qenë konkurrues me prodhimet e tyre në tregun global.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, për kryerjen e detyrave dhe të funksioneve të veta, ngre dhe administron laboratorë të ruajtjes së etaloneve kombëtare të matjeve, si dhe ato të kalibrimit e të verifikimit të instrumenteve matëse. Strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë i administrojnë këta laboratorë, sipas rregullave teknike dhe administrative, të përcaktuara.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë harton rregulloren e vet të funksionimit, e cila miratohet nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, ku përcaktohen të drejtat, detyrat dhe përkrahimi i vendit të punës të çdo hallke dhe të çdo funksioni, në veçanti.

6. Drejtori i përgjithshëm raporton, periodikisht, te ministri, që mbulon ekonominë.

7. Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës miraton planin vjetor të punës, planin ekonomik-financiar të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe informohet sistematikisht për zbatimin e detyrave në Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë.

8. Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës ndihmon, ndjek, monitoron dhe përgjigjet për veprimtarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, para Këshillit të Ministrave.

9. Veprimtaria për krijimin, ruajtjen dhe transmetueshmërinë e etaloneve kombëtare të matjeve, e cila kryhet në laboratorët e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë apo jashtë saj, financohet nga Buxheti i Shtetit.

10. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë bashkëpunon dhe shkëmben informacion me strukturat e pushtetit vendor, bashkitë dhe komunat, për zbatimin e ligjshmërisë dhe ekzekutimin e gjobave ndaj subjekteve, që kanë kryer kundërvajtje administrative në fushën e metrologjisë.

11. Struktura dhe organika e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë miratohen me urdhër të Kryeministrit.

12. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Drejtoria e

Përgjithshme e Metrologjisë për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha